



PROGRAM TRAJNIMI

Tiranë, 25–28 Maj 2026

Të dhëna të përgjithshme

Organizator	Instituti i Kontabilistëve të Miratuar (IKM)
Forma e zhvillimit	Auditor
Vendndodhja	Tiranë
Periudha	25 – 26, 28 Maj 2026
Pjesëmarrësit	Dega Tiranë

Programi i Sesioneve

Programi përbëhet nga tre sesione, të zhvilluara në tre ditë të njëpasnjëshme. Tabela më poshtë jep një përmbledhje; pjesa në vijim trajton secilin sesion në detaje, përfshirë objektivat dhe rezultatet e trajnimit.

Data	Moduli	Orari	Lektorët
25 Maj 2026	Paqja Fiskale, rivlerësimi i pasurisë dhe çështje të tjera fiskale	17:00 – 21:00	Zarina Taja, Rozana Çelmeta
26 Maj 2026	Teknologjia e Informacionit dhe siguria kibernetike	17:00 – 21:00	Specialist sigurie
28 Maj 2026	GDPR – Mbrojtja e të dhënave personale; Kontabilisti Ligjor dhe certifikimi	17:00 – 21:00	Nada Dollani, Armand Mala
Kohëzgjatja		12 orë	



SESIONI I — 25 Maj 2026

Data	25 Maj 2026
Orari	17:00 – 21:00
Kohëzgjatja	4 orë
Moduli	Udhëzimi për Paqen Fiskale, rivlerësimin e pasurisë dhe çështje të tjera fiskale
Lektorët	Zarina Taja, Rozana Çelmeta

Përshkrim i sesionit

Sesioni trajton kuadrin e ri ligjor të Paqes Fiskale — të dekretuar nga Presidenti i Republikës më 13 janar 2026 — dhe mbështetet në udhëzimet zbatuese të Ministrit të Financave. Trajtohen konkretisht ligji “Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale”, ligji “Për fshirjen, shuarjen dhe pagesën e detyrimeve tatimore dhe doganore”, fushata e re e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme me normë të reduktuar tatimore prej 5%, si dhe ndryshime të tjera të paketës fiskale 2026 me ndikim të drejtpërdrejtë në praktikën profesionale.

Objektivat

- Të njohin objektin, fushën e zbatimit dhe afatet e ligjit “Për Marrëveshjen e Paqes Fiskale” për tatimpaguesit me të ardhura bruto mbi 14 milionë lekë në vit, përfshirë aplikimin përmes platformës elektronike e-Filing dhe efektet ligjore të marrëveshjes.
- Të kuptojnë skemat e fshirjes së detyrimeve tatimore dhe doganore: fshirja e plotë e detyrimeve të krijuara deri më 31 dhjetor 2014, lehtësimet me kushte për periudhat 2015–2019 dhe 2020–2024, si dhe trajtimi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- Të zotërojnë kuadrin e rivlerësimit të pasurive të paluajtshme me normë 5% (në fuqi nga 1 janari 2026), përfshirë dokumentacionin, përdorimin e ekspertit të licencuar dhe trajtimin kontabël të diferencës nga rivlerësimi në pasqyrat financiare.

Rezultatet

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Vlerësojnë nëse një klient i caktuar plotëson kushtet për të hyrë në Marrëveshjen e Paqes Fiskale dhe përgatisin aplikimin përmes e-Filing brenda afatit të dorëzimit të deklaratës vjetore të të ardhurave.
- Hartojnë një plan veprimi për përfitim nga skema e fshirjes së detyrimeve, duke shqyrtuar bilancin e detyrimeve të vjetëruara dhe duke përzgjedhur opsionin më të leverdishëm (pagesë e plotë, 50% me një këst, 75% me këste mujore).



- Hartojnë regjistrime kontabël të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme në përputhje me SKK 7 / SNK 16, përfshirë trajtimin e tepricës nga rivlerësimi (kapitali i rivlerësimit) dhe efektet tatimore.
- Përgatitin dokumentacionin e kërkuar për bashkëpunim me ekspertë të licencuar të vlerësimit të pasurive dhe komunikim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për procesin e rivlerësimit.



SESIONI II — 26 Maj 2026

Data	26 Maj 2026
Orari	17:00 – 21:00
Kohëzgjatja	4 orë
Moduli	Teknologjia e Informacionit në Profesionin e Kontabilitetit dhe siguria kibernetike
Lektorët	Specialist sigurie kibernetike

Përshkrim i sesionit

Sesioni paraqet një pamje të transformimit dixhital të profesionit dhe të kërcënimeve kibernetike që prekin shoqëritë e kontabilitetit dhe klientët e tyre. Trajtohen kategoritë kryesore të teknologjive (cloud, automatizimi i proceseve, faturimi elektronik, inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave).

Objektivat

- Të njohin gjendjen aktuale të teknologjive të informacionit në profesionin e kontabilitetit në Shqipëri
- Të kuptojnë llojet kryesore të kërcënimeve kibernetike (phishing, ransomware, kompromentim i kredencialeve, mashtrim përmes e-mail-it të biznesit/BEC), bazuar edhe në rastet konkrete të raportuara në Shqipëri dhe rajon.
- Të zotërojnë parimet bazë të mbrojtjes kibernetike: vërtetim me dy faktorë, menaxhim i fjalëkalimeve, sigurim i të dhënave (backup), përditësimet e sistemit, kontrolli i aksesit dhe ndarja e detyrave në sistemet kontabël.
- Të kuptojnë lidhjen mes sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave personale (Ligji 124/2024).
- Të orientohen mbi mundësitë e shërbimeve të reja këshilluese që profesionisti kontabël mund t'u ofrojë SME-ve në fushën e qeverisjes së të dhënave dhe vlerësimit të rrezikut kibernetik.

Rezultatet

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Kryejnë një vlerësim bazë rreziku kibernetik për shoqërinë e tyre të kontabilitetit ose për një klient SME, duke identifikuar elementet kritike të informacionit dhe pikat kryesore të cenueshmërisë.
- Zbatojnë një grup kontrollesh teknike dhe organizative: politika fjalëkalimesh, vërtetim me dy faktorë (MFA), backup të rregullt, kriptim i pajisjeve, plan i vazhdimësisë së veprimtarisë.



- Hartojnë procedura të brendshme për reagimin ndaj një incidenti të dyshuar kibernetik, përfshirë kohën e njoftimit të klientit, të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe — nëse është rasti — të organet ligjzbatuese.
- Identifikojnë rastet ku përdorimi i AI-së në kontabilitet kërkon kujdes të veçantë etik, veçanërisht rrezikun e cenimit të konfidencialitetit kur të dhënat e klientit ngarkohen në modele publike.

SESIONI III — 28 Maj 2026

Data	28 Maj 2026
Orari	17:00 – 21:00
Kohëzgjatja	4 orë
Moduli	GDPR – Mbrojtja e të dhënave personale; Kontabilisti Ligjor dhe certifikimi i tij
Lektorët	Nada Dollani, Armand Mala

Përshkrim i sesionit

Sesioni ndahet në dy pjesë të integruara. Pjesa e parë (Prof. Dr. Nada Dollani) trajton kuadrin e ri ligjor të mbrojtjes së të dhënave personale: Ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në fuqi nga shkurti i 2025-ës dhe i përafuar plotësisht me Rregulloren GDPR të BE-së), si dhe Rregulloren e Përgjithshme (BE) 2016/679. Fokus të veçantë do të ketë mbi detyrimet specifike të profesionistit kontabël si kontrollues dhe përpunues të dhënash, si dhe mbi praktikën e parë të vendimeve të Komisionerit. Pjesa e dytë (Z. Armand Mala) jep një hyrje të përgjithshme në profesionin e Kontabilistit Ligjor — një specializim i ri që ndërtohet mbi kualifikimin e Kontabilistit të Miratuar dhe që pajis profesionistët me aftësitë e nevojshme për ekzaminimin e mashtrimit, hetimin e krimit financiar dhe ofrimin e dëshmisë së ekspertit në procese gjyqësore. Programi i certifikimit i IKM-së është përafuar me standardet ACFE dhe AICPA, dhe është përshtatur për kontekstin ligjor dhe institucional shqiptar.

Objektivat

- Të njihen me parimet bazë të Ligjit nr. 124/2024 dhe GDPR-së: ligjshmëria, qëllimi i kufizuar, minimizimi i të dhënave, saktësia, kufizimi i ruajtjes, integriteti dhe konfidencialiteti, llogaridhënia.
- Të kuptojnë rolet e kontrolluesit dhe të përpunuesit të të dhënave në marrëdhënien profesionist–klient, si dhe detyrimin e ri për lidhjen e marrëveshjes kontrollues–përpunues sipas Ligjit 124/2024.
- Të identifikojnë detyrimet kryesore: bazat ligjore të përpunimit, njoftimet drejtuar subjektit, kohëzgjatja e ruajtjes, regjistri i veprimtarive të përpunimit, vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave (DPIA), raportimi i shkeljeve.
- Të kuptojnë rolin dhe fushën e veprimit të Kontabilistit Ligjor si specializim i ekzaminimit të mashtrimit dhe hetimit të krimit financiar — të dallueshëm nga shërbimet e zakonshme të kontabilitetit.



- Të njihen me trekëndëshin e mashtrimit (presioni, mundësia, racionalizimi) dhe llojet kryesore të skemave të mashtrimit: mashtrim në pasqyrat financiare, korrupsion dhe ryshfet, keqpërdorim i aktiveve.
- Të orientohen mbi rrugën e certifikimit të Kontabilistit Ligjor brenda IKM-së: kualifikimi i Kontabilistit të Miratuar si parakusht, struktura e programit (modulet, orët, provimi), dhe përafrimi me standardet ndërkombëtare ACFE/AICPA.

Rezultatet

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Hartojnë ose përditësojnë politikat dhe procedurat bazë të mbrojtjes së të dhënave për shoqërinë e kontabilitetit: politikë privatësie, regjistër i veprimtarive të përpunimit, procedurë për trajtimin e kërkesave të subjekteve.
- Reagojnë siç duhet ndaj një shkeljeje të të dhënave: dokumentojnë incidentin, vlerësojnë rrezikun për të drejtat dhe liritë e individëve, dhe — kur kushtet plotësohen — njoftojnë Komisionerin brenda 72 orëve dhe subjektet e prekura.
- Lidhin marrëveshjen kontrollues–përpunues kur shoqëria vepron si përpunuese për llogari të klientëve (p.sh. shërbime payroll-i ose kontabiliteti me akses në të dhëna personale).
- Identifikojnë rastet në praktikë ku angazhimi i një Kontabilisti Ligjor është i nevojshëm — p.sh. dyshimi për mashtrim financiar, kërkesa nga prokuroria apo gjykata për ekspertizë, vlerësim i pavarur i pasqyrave, hetim i brendshëm për keqpërdorim aktivesh.
- Aplikojnë parime etike dhe konfidencialiteti në praktikën e përditshme, duke pasur parasysh detyrimet e dyfishta që rrjedhin nga Ligji 124/2024 dhe Kodi i Etikës i IESBA-s.